

**“WVP – ndërmjetësim në sigurime” Sh.a.**  
NUIS K62324003M  
Selia Rruga Brigadave, Pallati 18, Hyrja 6, Ap. 11, Tiranë, Shqipëri,

---

Tiranë, më 12.05.2025

**NJOFTIM PËR ZHVILLIMIN E**  
**ASAMBLESE SË AKSIONERËVE TË SHOQËRISË**  
**WVP – NDËRMJETËSIM NË SIGURIME SH.A.**

Të nderuar aksionarë,

Me anë të këtij njoftimi dëshiroj t’ju bëj me dije se më datën **27 Qershor 2025 ora 16:00** në zyrën e WVP në adresën: Rruga Barrikadave, Ndërtesa 18 H 6 Ap. 11, Tiranë, Shqipëri do të zhvillohet Mbledhja e Asamblesë së aksionarëve të shoqërisë WVP – Ndërmjetësim në Sigurime SHA!

Në rend të ditës së mbledhjes së asamblesë së aksionarëve janë për diskutim dhe vendimmarrje çështjet e mëposhtme:

- 1. Miratimi i pasqyrave financiare për vitin 2024 për Shoqërinë WVP NDERMJETESIM NE SIGURIME SH.A**
- 2. Të ndryshme**

Në lidhje me pikën e dytë lutemi që nëse aksionerët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë mendojnë se ka diçka për të diskutuar, të paraqesin mendimin e tyre në adresë të administratorit (kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike) si dhe dokumentacionin përkatës që mendon se është i nevojshëm tu shpërndahet aksionarëve paraprakisht, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së përcaktuar për zhvillimin e mbledhjes.

Ju sjell në vëmendje se për të marrë pjesë në mbledhjen e asamblesë së aksionarëve, aksionerët duhet të paraqiten në ditën dhe orën e përcaktuar më sipër, në selinë e shoqërisë, sipas adresës së përcaktuar më sipër. Aksionerët mund të paraqiten dhe të

marrin pjesë personalisht apo nëpërmjet perfaqësuesve të autorizuar. Si përfaqësues i aksionerit mund të jetë një aksioner tjetër apo një person i tretë. Administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionerëve në asamblenë e përgjithshme.

Njoftimin e mbledhjes dhe dokumentacionin përkatës (nëse ka) mund ta gjeni edhe në faqen web të shoqërisë në adresën në internet [www.wvp.al](http://www.wvp.al)

Zotërimi i aksioneve aktualisht në shoqëri është si vijon:

- “WVP”, person juridik i themeluar dhe regjistruar në shtetin austriak, me nr. të regjistrimit tregtar FN 48957x, me seli në Brauquartier 11/1 OG/Top 8, 8055 Grac, Austri, zotëron [90%] ([nëntëdhjetë përqind]) të aksioneve të kapitalit të shoqërisë, ose 9900 aksione.
- Z. Ali Lena zotëron [5,5%] ([pesë presje pesë përqind]) të aksioneve të kapitalit të shoqërisë, ose 605 aksione.
- Z. Kujtim Ibraimi zotëron [4%] ([katër përqind]) të aksioneve të kapitalit të shoqërisë, ose 440 aksione.
- Z. Petar Andreevski zotëron [0,5%] ([zero presje pesë përqind]) të aksioneve të kapitalit të shoqërisë ose 55 aksione.

Numri i votave në asamblenë e aksionerëve, që ka secili aksioner është i barabartë me numrin e aksioneve që zotëron secili prej tyre.

Për sa më sipër, lutemi që çdo kërkesë të paraqitet në adresë të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë Znj. Valmira Tace, në selinë e shoqërisë.

Lutemi konfirmoni marrjen e njoftimit për zhvillimin e mbledhjes së asamblesë.

**Administratori**  
**Valmira Tace**

